



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KOLEGJI AAB
RAPORT PËR MONITORIMIN

30.05.2023, Prishtinë

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të AKA-së për procedurën e monitorimit të orarit të ligjëratave:

- *Naim Gashi, Drejtor;*
- *Ilirijana Ademaj Ahmeti, Zyrtare e Lartë për Vlerësim dhe Monitorim;*
- *Mirlinda Xhylani, Prkatikante në AKA.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 23.05.2023

Monitorimi është realizuar: a) në distancë
b) me vizitë në terren me paralajmërim
c) me vizitë në terren pa paralajmërim

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 23.05.2023

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Furtuna Mehmeti, Koordinatore për cilësi në nivel të Kolegjit AAB.*
- *Shemsedin Vehapi, Prorektor.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave dhe punës praktike;*
- *Listat e pjesëmarrësve të studentëve;*
- *Intervista me profesorë dhe studentë.*

2. Përshkrim i shkurtër i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 10:00, në kampusin në Prishtinë

Gjate vizitës, ekipi monitorues u takua me znj. Furtuna Mehmeti koordinatore për cilësi në Kolegjin AAB dhe z. Shemsedin Vehapi prorektor. Bashkëpunimi i stafit përgjegjës për sigurim të cilësisë ishte korrekt dhe ishin në dispozicion për të ofruar sqarime dhe përgjigje ndaj kërkesave të ekipit monitorues.

Ekipi monitorues fillimisht paraqiti kërkesë për dëshmi lidhur me oraret e ligjëratave, ushtrimeve dhe punës praktike për programet, kërkesa të cilat janë përzgjedhur nga ekipi monitorues me metodën e rastit:

1. Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA;
2. Programet e Shkencave Kompjuterike:
 - 2.1. Siguri Kibernetike BA Profesional;
 - 2.2. Programim BA Profesional.
3. Infermieri, BSc.

Pas pranimit të të gjitha këtyre dëshmimeve dhe bazuar në këto të dhëna, ekipi monitorues verifikoi mbarëvajtjen e mësimit në përputhje me orarin e ligjëratave (dhe ushtrimeve). Gjatë verifikimit, ekipi monitorues konstatoi se në të gjitha ambientet e mësimit ishin prezentë mësuesit dhe studentët e prezantuar sipas listës së orareve dhe ligjëratave.

Në vazhdim të vizitës monitoruese, ekipi është takuar me disa studentë të Programit Infermieri, BSc, dhe ka biseduar për mbarëvajtjen e punës praktike. Në fokus të bisedës, ka qenë orari i punës praktike, përcjellja dhe mentorimi i këtyre studentëve nga ana e infermierëve në klinikat përkatëse, si dhe qasja dhe përfshirja e tyre në punën me pacientë.

Pastaj, nga menaxhmenti i programit të Infermierisë, ekipi monitorues ka kërkuar dhe më pastaj ka pranuar listat dhe oraret e punës praktike për studentët e infermierisë, si dhe kontratat e Kolegjit AAB me mentorët klinikë.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

1. Ekipi monitorues ka konstatuar se mbarëvajtja e ligjëratave dhe punës praktike ka qenë në përputhje me oraret dhe dokumentet tjera të paraqitura si dëshmi.
2. Nga biseda me studentë, ekipi monitorues ka vërejtur se puna praktike në klinikat përkatëse është duke u mbajtur me rregull (studentët kanë qenë të kënaqur me mentorët për shkak të angazhimit të tyre nëpër klinika gjatë punës praktike).
3. Në listat e orareve dhe ligjëratave të prezantuara nga Kolegji AAB është verifikuar se specializimi për “Inxhinieri Softuerike” paraqitet si program, deri sa nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është i akredituar me emrin e programit “Shkenca Kompjuterike Bsc”,


me specializim “Inxhinieri Softuerike” dhe “Telekom dhe Rrjeta Kompjuterike”. Pas vërejtjeve të ekipit të AKA kjo e gjetur është korrigjuar.

4. **SHTOJCAT** (dokumentet e mblledhura gjatë vizitës)

1. Listat e ligjëratave për programet në “Shkenca Kompjuterike”;
2. Listat e pjesëmarrësve në programin “Infermieri”;
3. Orari i ligjëratave për semestrin e dytë në programin “Infermieri”;
4. Lista e pjesëmarrësve në punë praktike në QKUK dhe QKMF në programin “Infermieri”;
5. Kontratat e Kolegjit AAB me mentorët klinikë;
6. Listat e ligjëratave për programet në “Banka Financa dhe Kontabilitet”;

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

NAIM BASHI  _____
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Elizana Ademaj Ahmet  _____
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Mirliodë Gashi - Xhytami  _____
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)